


Raporti i pestë tremujor

1. janar – 31. mars, 2012.



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



 UNOPS

Sprovodi program



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Rezyme

Shpallja e zgjedhjeve parlamentare dhe lokale më 6 maj menjëherë ka nxitur një turmë aktivitete promovuese dhe negociata mbi koalicionet në tërë territorin e përgjegjësishë së EU PROGRES. Katër parti politike shqiptare janë deklaruar që do të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare përderisa në jugperëndim të Serbisë kanë vazhduar spekulimet mbi angazhimin e mundshëm të myftisë Zukorliq.

EU PROGRES deri më tani ka nënshkruar 120 marrëveshje për ndihmë të pakthyeshme në vlerë prej më shumë se 4.4 milion euro. Me rëndësi të barabartë është edhe ndihma këshillëdhënëse të cilën programi vazhdon të ia ofrojë partnerëve në jug dhe jugperëndim të Serbisë. Disa nga iniciativat kyçe të cilat i ka mbështetur përfshijnë: 40 projekte të cilët janë duke u zbatuar në partneritet në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe vetëqeverisjeve lokale, 25 projekte infrastrukturore, dy projekte infrastrukturore të mëdha ndër-komunale, 23 projekte mbështetëse në zhvillimin e planeve të rregullimit, zhvillimin e dokumentacionit teknik për tetë projekte komunale prioritare dhe tre projekte lidhur me dhënien e ndihmës juridike falas.

Implementimi i projekteve, megjithatë, edhe më tej ballafaqohet me një varg pengesash dhe momentalisht 55 (49%) projekte janë duke u zbatuar me vonesë, përderisa zbatimi i tetë projekteve mund të karakterizohet si kritik. EU PROGRES aplikon modelin e zbatimit indirekt, që do të thotë që shfrytëzuesit marrin ndihmë të pakthyeshme dhe kanë „pronësinë“ mbi aktivitetet e caktuara të projekteve. Kjo qasje është më e dobishme kur bëhet fjalë për ngritjen e kapaciteteve por paraqet edhe shkakun kryesor të vonimit në zbatimin e projektit. Për shembull, komunat janë ballafaquar me vështirësi në sigurimin e mjeteve me kohë për ko-financim, në sigurimin e dokumentacionit teknik kualitativ për projektet e aprovuara infrastrukturore, në zbatimin e procedurave të prokurimit publik si dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, që ka shkaktuar vonesë por nuk ka rrezikuar zbatimin e shumicës së projekteve. Implementimi i aktiviteteve është vështirësuar edhe për shkak të dimrit të ashpër i cili e ka goditur Serbinë në janar dhe shkurt 2012.

EU PROGRES ka themeluar dhe mbanë lidhje të forta me Qeverinë e Republikës së Serbisë, si dhe agjencitë zhvillimore dhe programet. Ky partneritet reflektohet në projektet e përbashkëta dhe aktivitetet me Ministrinë e ambientit jetësor, minierave dhe planifikimit hapësinor, Ministrinë e ekonomisë dhe zhvillimit regional, Ministrinë për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, administratën qeveritare dhe vetëqeverisëse lokale, Zyrën për zhvillim të qëndrueshëm të regjioneve të pazhvilluara dhe Trupin Koordinues për Komunitet Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, kurse në aspektin e LSU, çështja e ko-financimit të cilën e sigurojnë ministrinë dhe qasjet në projektet e përbashkëta, shkaktojnë vonesë dhe pasiguri që po ashtu ngadalësojnë përfundimin e projekteve me kohë.

Komiteti drejtues i programit (KDP) në muajin shkurt ka mbajtur takim në Leskoc dhe ka aprovuar projekte në vlerë më shumë se gjysmë milioni euro. Ata kanë të bëjnë me prodhimin regional të pemëve në rrethin e Pčinjës, qasjen në ndihmën e shpejtë në Bllacë, rregullimin e lumit Strazhevicë në Prokuplje, ndërtimin e tregut të qumështit në Zhitragji, dizajnimin e dokumentacionit teknik për bartjen e mbeturinave në Sjenicë si dhe konceptin e kampanjës për barazi gjinore. Kryesuesi i KDP ka deklaruar që Zyra për integritet evropian RS (ZIE) do të fillojë konsultimet mbi programin i cili ndoshta do ta trashëgojë EU PROGRES dhe ka lutur EU PROGRES që të ndihmojë gjatë konsultimeve lokale.

Ky raport përmban informata mbi zhvillimin e ndodhive në tre muajt e parë në 2012. Në kapitullin 1 është dhënë pasqyra e qëllimeve, rezultateve dhe shfrytëzuesve të EU PROGRES.



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu**progres** ▶▶

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Në kapitullin 2 janë paraqitur informatat më të reja mbi zhvillimet politike, shoqërore dhe ekonomike, përdërsa në kapitullin 3 është dhënë pasqyra e hollësishme e aktiviteteve të Programit. Kapitulli 4 fokusohet në çështjet e menaxhimit kurse kapitulli 5 përmban pasqyrën e partneriteteve të cilëve Programi i ka kontribuar. Kapitulli i fundit, kapitulli 6, ofron informacione mbi dukshmërinë e Programit.

Në shtojca janë paraqitur informatat e hollësishme mbi disa aktivitete konkrete në kuadër të Programit.